

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar mbi njoftimin për përqendrim të parashtruar nga United Media S.à r.l., me seli të regjistruar në adresën Rue Jean Monnet 6, L-2180, Luksemburg, Luksemburg dhe Motor Oil (Hellas) Corinth Refineries S.A., me seli të regjistruar në adresën Irodou Attikou 12a, 151 24 Maroussi, Atikë, Greqi, përmes përfaqësueses së autorizuar Ljupka Noveska Andonova, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 25.02.2025, sollli këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin United Media S.à r.l., me seli të regjistruar në adresën Rue Jean Monnet 6, L-2180, Luksemburg dhe Motor Oil (Hellas) Corinth Refineries S.A., me seli të regjistruar në adresën Irodou Attikou 12a, 151 24 Maroussi, Atikë, Greqi, fitojnë kontroll të përbashkët mbi Nevine Holdings Limited, me seli në adresën Akropoleos 66, Akropolis Tower, Strovolos 2012, Nikozia, Qipro dhe me të cilin United Media S.à r.l. fiton kontroll të pavarur mbi Marticorio Limited, me seli në adresën Akropoleos 66, Akropolis Tower, Strovolos 2012, Nikozia, Qipro, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin vijues: Ligji), më datë 12.12.2024 dhe plotësuar më 11.02.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) iu dorëzua njoftimi për përqendrim nga United Media S.à r.l., me seli të regjistruar në adresën Rue Jean Monnet 6, L-2180 Luksemburg dhe Motor Oil (Hellas) Corinth Refineries S.A., me seli të regjistruar në adresën Irodou Attikou 12a, 151 24 Maroussi, Atikë, Greqi, me anë të të cilit United Media S.à r.l. dhe Motor Oil (Hellas) Corinth Refineries S.A. fitojnë kontroll të përbashkët mbi Nevine Holdings Limited, me seli në adresën 66 Akropoleos, Acropolis Tower, Strovolos 2012, Nikozia, Qipro dhe me anë të të cilit United Media S.à r.l. fiton kontroll të pavarur mbi Marticorio Limited, me seli në adresën 66 Akropoleos, Acropolis Tower, Strovolos 2012, Nikozia, Qipro.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

United Media S.à r.l. është në pronësi të plotë të fondeve të këshilluara nga BC Partners, një fond investimesh ndërkombëtar me seli në Londër. Fondet BC janë investitorë thjesht financiarë, pra nuk përfshihen në menaxhimin e përditshëm të kompanive në të cilat investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtuesve.

BC Partners ka prani të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të mëposhtme të varura indirekt:

-TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në adresën Bulevardi Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me shpërndarjen e përmbajtjeve mediatike përmes platformave teknike DTH,

-DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në adresën Kosta Veselinov nr. 5-1, lokal 2/Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me aktivitete marketingu, përkatësisht blerjen dhe shitjen e hapësirës reklamuese në media të shtypura dhe elektronike,

-UGI FIBER DOOEL Shkup, me seli në adresën Bulevardi Partizanski Odredi nr. 14, Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me aktivitete të telekomunikacionit satelitor.

Motor Oil (Hellas) Corinth Refineries S.A. është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Greqisë, e listuar në bursën e Athinës. Motor Oil (Hellas) vepron në sektorin e përpunimit të naftës. Gjithashtu, përmes shoqërive të saj të varura, ajo është aktive në shitjen e derivateve të naftës, si shitja me pakicë dhe shumicë e karburanteve, burimet e rinovueshme të energjisë (BRE), menaxhimin e mbetjeve, biokarburantet, etj. Motor Oil (Hellas) ka qenë eksportuese e derivateve të naftës për gati pesë dekada, ku pjesa më e madhe e prodhimit shitet për blerës në vendet e huaja.

Motor Oil (Hellas) Corinth Refineries S.A. ka shoqëritë e mëposhtme të varura në Maqedoninë e Veriut:

CORAL-FUELS SHPKNJP Shkup, me seli në adresën Dimitrija Çupovski nr. 4/2-3, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, aktiviteti kryesor i së cilës është tregtia me derivate të naftës. CORAL-FUELS SHPKNJP Shkup ka licencë për përdorimin e markës SHELL në Maqedoninë e Veriut. Shoqëria menaxhon dy stacione karburantesh nën markën SHELL në Maqedoninë e Veriut.

MOTOR OIL RENEWABLES ENERGY SHPKNJP Shkup, me seli në adresën Gjorgji Dimitrov nr. 16-1/3, Shkup - Kisela Voda, Maqedonia e Veriut, me aktivitet kryesor tregtinë me energji elektrike.

Shoqëritë e Synuara Martikorio Limited dhe Nevene Holdings Limited janë shoqëri holding. Shoqëria kryesore e varur e Shoqërive të Synuara është Alpha Satellite TV S.A., një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Greqisë, me seli në adresën Viltanioti 36, Kifisia, Attica, Greqi.

Kjo shoqëri është aktive në Greqi në ofrimin e transmetimit digjital falas të programeve televizive të destinuara për informimin e përgjithshëm të zonës së folur greke. Kjo shoqëri menaxhon kanalin televiziv me emrin "A" (ALFA).

Gjithashtu, programet e Alpha Satellite TV janë të disponueshme përmes faqes në internet www.alphatv.gr, si dhe përmes televizionit hibrid HbbTV. Përveç kësaj, kanali TV ALFA transmetohet në rrjetet kabllore të operatorëve të telekomunikacionit grekë Nova dhe Cosmote, në bazë të marrëveshjes për licencën e ritransmetimit. Një pjesë e programeve televizive të ALFA TV transmetohen në Qipro.

Asnjë nga Shoqëritë e Synuara, përfshirë Alpha Satellite TV, nuk është e pranishme dhe nuk ka të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ